



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:196630
Datë: 18.12.2023
Numri i dokumentit: 05080171

PPP. nr. 10/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Sh.A K..., kundër debitorit S... SH.P.K A.S, nga Komuna e Gllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej 624.93 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat I.M, P. nr... të datës 20.12.2019, jashtë seance me datë 18.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit S... SH.P.K A.S nga Gllogoci, kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat P.nr... të datës 20.12.2019, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit Sh.a K..., për përmbarimin e borxhit në shumën prej 624.93 €, 8% në vit duke filluar nga pranimi i këtij vendimi gjer në pagesën definitive të detyrimit, dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, ndërsa urdhëri i Përmbaruesit Privat I.M, P. nr... i datës 20.12.2019 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat I.M, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të **Ekstraktit nga Librat Afariste** – me shenjën DPR...

Kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit, në afat ligjor debitori ka paraqitur prapësim duke theksuar se: *nuk ka obligime ndaj Kreditorit duke theksuar se e kanë ndërtnuar objektin shkollor në fsh... KK Gllogoc por e kanë ndërprerë para kohe kontratën me Ministrinë e Administratës Publike për mos alokimin të mjeteve buxhetore për shkak të sasive apo punëve shtesë që kanë rrjedh si jo harmonizim të projektit me paramasa si në kontratë, po ashtu asnjëherë prej datës 14.09.2017 ku shihet edhe në bazë të faturës nuk kemi bërë harxhime meqë nuk kemi punuar fare, shtojnë faktin se orën në fjalë MAP e ka shfrytëzuar për nevoja të veta, ja kemi tërhequr vërejtjen që ora duhet të hiqet dhe të vendoset matësi i ri në emër të shkollës, po ashtu kanë njoftuar edhe personat zyrtar të K... në Gllogoc që të marrin veprime të tillë po asnjëra palë nuk ka ndërmarr asnjë veprim, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par.1 të LPP-së të*

aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbardim i përmbarduesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, duke propozuar që urdhëri i përmbarduesit privat për caktimin e përmbardimit P. nr... i datës 20.12.2019 të mbetet në fuqi. Ka theksuar se: *lidhur me pretendimin e debitorit nuk mund të merren parasysh pasi që për vërtetimin e saktë të shfrytëzuesit të supozuar nga ana e debitorit në historikun e konsumatorëve nuk ka kërkesa për ndërrimin të pronarit (Shfrytëzuesit). Kompania nuk mund të dijë se kush është pronari përderisa nuk ka kërkesë tek zyra për përkujdesje ndaj konsumatorëve për ndërrim të emrit dhe siç përshihet në procedurën për mbylljen e llogarisë së konsumatorit dhe aktivitet e ndërlidhura neni 3, pronari është i njëjti që nga dita e parë e nënshkrimit të kontratës. Propozimi për përmbardim është bërë për periudhën 29.09.2017 deri me datën 12.11.2019 duke i bashkuar në propozim për përmbardim **Ekstrakti nga Librat Afariste**, tek kriteri Minimal është precizuar Borxhi Kumulativ jo i ndarë nga fatura për faturë mujore, dhe se debitori prapësimin e ka paraqitur vetëm për të zvarritur procedurën përmbardimore, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P. nr... i datës 20.12.2019 të mbetet në fuqi.*

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye si në vazhdim.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbardim e ka bërë për përmbardimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktin e lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbarduesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbardimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto ekstrakte si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbardimi, se çka përmban dokumenti i përmbardimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbardim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbardimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm – **ekstraktet**, nga të cilat shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim nga Kreditorit pasi që e ka ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale me Ministrin e Administratës Publike dhe ka bërë thirrje që të ndërrohet pronari i njuhësorit, mirëpo një gjë e tillë sipas tij nuk ka ndodhur edhe pse i njëjti ka bërë vërejtje dhe se njuhësorin matës pasi që është ndërprerë kontrata mes debitorit dhe Ministrisë këtë orë e ka shfrytëzuar MAP. Gjykata këtë nuk e aprovoj pasi që këto pretendime nuk qëndrojnë sepse sipas transaksionit të konsumatorit DPR-... vërtetohet fakti se Njuhësori Matës ka figuruar në emër të debitorit dhe se për pretendimet e tij se ka bërë kërkesë për ndërrim pronari tek njuhësori nuk ofruar ndonjë provë që do të dëshmonte një gjë të tillë.

Kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbardim i ka bashkangjitur **ekstraktet e vërtetuara** të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për tu trajtuar dokument i besueshëm në kuptim të Nenit 29 par. 1.2 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi Urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P. nr... të datës 17.06.2019 duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 10/20, datë 18.12.2023

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.